



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1554  
Datë: 30 / 6 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, shpall:

**KONKURS**

**për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2025-2026**

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 20 pika 2, nën-pika 2.2 dhe në zbatim të nenit 99 të Statutit, në mbledhjen e mbajtur më 28.5.2025, ka miratuar propozimet e njëjësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2025/2026 dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet e nivelit master.

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Universiteti i Prishtinës për studimet postdiplomike-master, për vitin akademik 2025-26, do të regjistrojë **2300** studentë, nga të cilët **9** studentë ndërkombëtarë.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi, duke u bazuar në UA (MASHT) Nr. 09/2016, universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri **270** studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në studimet postdiplomike-master në Universitetin e Prishtinës mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në Universitetin e Prishtinës.
4. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë, të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Në raste të tilla, dëshmia për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa barasvlera e notave do të bëhet në njësinë akademike përkatëse nga koordinatori për zhvillim akademik.
5. Kandidatët, të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi, Komisioni i Studimeve i njëjësive akademike cakton provime diferenciale, të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Komisioni i Studimeve cakton numrin e provimeve, varësisht nga shkalla e krahasueshmërisë/ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe u nënshtrohen provimeve diferenciale në afatet e qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më

së shumti deri në pesë (5) provime diferenciale, të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh, ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësish akademike përkatëse.

6. Përjashtim nga paragrafi 3 i pikës I të këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vetë njësitë akademike.
7. Universiteti i Prishtinës, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e aplikimit, do t'ua shtojë nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
8. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër, pa i përfunduar studimet ose pa u çregjistruar nga programi ku janë duke vijuar studimet.**
9. **Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2025/26 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.**

## II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:  
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
  - Suksesi në studimet themelore deri në 30 pikë;
  - Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.
2. Përveç provimeve nga lëndët profesionale, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit edhe në gjuhë angleze, nga i cili mund të sigurojnë deri në 10% të pikëve të provimit pranues. Nëse kandidati dëshmon që ka certifikatë ndërkombëtare TOEFL me së paku 79 pikë (ose IELTS me së paku 5.65 pikë), i njëjti me automatizëm merr 5 pikë, ndërsa pikët tjera lidhur me gjuhën angleze shtohen varësisht nga suksesi i treguar në provimin pranues - pjesën e gjuhës angleze.
3. Përjashtim nga paragrafi 2 i kësaj pike do të bëhet për kandidatët që aplikojnë në programet e gjuhëve të huaja në Fakultetin e Filologjisë, ku provimi do të mbahet në gjuhën e programit studimor.
4. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
5. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
6. Kandidatët, të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen, edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët të tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta, atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprake. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë femërore, përzgjedhja e kandidatës për pranim do të

bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidateve me pikë të barabarta. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidateve me pikë të barabarta. Sekretari i fakultetit përkatës është i obliguar që listën e kandidateve të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojë Zyrës për Shërbime të Studentëve të universitetit, gjithashtu ta dërgojë për publikim në ueb-faqen e fakultetit.

8. Në qoftë se në afatin e parë të konkursit mbesin vende të paplotësuara për shkak se jo të gjithë kandidatët kanë arritur të kalojnë pragun minimal të pikëve, atëherë do të shpallet konkurs plotësues për plotësimin e vendeve të lira.
9. Në rast se edhe pas shpalljes së konkursit plotësues mbesin vende të lira në kategorinë e komunitetit joshumicë, për shkak se jo të gjithë kandidatët kanë arritur të kalojnë pragun minimal të pikëve, atëherë plotësimi i vendeve të rezervuara për komunitetin jo shumicë do të bëhet sipas ranglistës së pikëve me kandidatë që e kanë kaluar pragun e kalueshmërisë në afatin e parë të konkursit dhe që i takojnë komunitetit shumicë. Nëse nga afati i parë nuk ka kandidatë në listën e pritjes për arsye të mosarritjes së pragut të kalueshmërisë, atëherë plotësimi i vendeve të lira do të bëhet sipas ranglistës së pikëve, me kandidatë që kanë kaluar pragun e kalueshmërisë në afatin e dytë - konkursin plotësues.
10. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimit ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal i studentëve, i përcaktuar me rregullore apo akt tjetër të brendshëm.

### **III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM**

**Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:**

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> hapet prej datës **30.6.2025** deri me datë **11.7.2025**, në orën **14:00**. Gjatë kësaj periudhe do të bëhet edhe dorëzimi i dokumentacionit fizik nga kandidatët. Dokumentacioni do të pranohet çdo ditë, me përjashtim të të dielave.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **30.6.2025**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **14:00**.
3. Gjatë periudhës së aplikimit do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula e noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:**
  - a) *Ekstraktin e lindjes (origjinale);*
  - b) *Diplomën, përkatësisht certifikatën e diplomimit, të noterizuar (dokument origjinal);*
  - c) *Dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatë që kanë të mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës);*

- d) Fletëparaqitja e plotësuar, e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: *Vegëza (Linku) për aplikim online përmes internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>;*
- e) Kandidatët, me rastin e aplikimit, bazuar në UA (MASHTI) Nr. 09/2021, lirohen nga pagesa e provimit pranues.

Provimi pranues do të mbahet më **14.7.2025** dhe **15.7.2025**, sipas orarit si në vijim:

#### **Grupi I:**

1. Fakulteti Filozofik, datë **14.7.2025** në ora **9:00**
2. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, datë **14.7.2025** në ora **9:00**
3. Fakulteti i Ekonomisë, datë **14.7.2025** në ora **9:00**
4. Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinës, datë **14.7.2025** në ora **9:00**
5. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, datë **14.7.2025** fillon në ora **9:00-12:00**
6. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, më **14.7.2025** në ora **8:00**

#### **Grupi II:**

1. Fakulteti i Filologjisë, datë **15.7.2025** në ora **9:00**
2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, datë **15.7.2025** fillon në ora **9:00-11:00**
3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, datë **15.7.2025** fillon në ora **9:00-11:00**
4. Fakulteti Juridik, datë **15.7.2025** në ora **9:00**
5. Fakulteti i Mjekësisë, datë **15.7.2025** nga ora **15:00**
6. Fakulteti i Arteve, datë **15.7.2025** nga ora **9:00**.
7. Fakulteti i Arkitekturës, datë **15.7.2025** në ora **09:00**
8. Fakulteti i Edukimit, datë **15.7.2025** në ora **9:00**.

1. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
2. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

#### **IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE**

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues për të dy grupet do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve, **më së voni deri më 16.7.2025, në ora 16:00.**
2. *Rezultati preliminar nuk është rezultat përfundimtar. Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, pasi me rastin e miratimit si të bazuar të ankesës, dikush nga kandidatët mund të radhitet më lart me pikë se kandidati i radhitur sipas rezultatit preliminar.*

#### **V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË**

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preliminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare** (llogaritet edhe dita e shtunë), respektivisht: **për të dy grupet më së voni deri më datë 18.7.2025, në ora 16:00.**

2. Pas afatit të përcaktuar si në pikën e sipërhënuar, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet, menjëherë pas mbylljes së afatit ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës.

## VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. **Shpallja e rezultateve përfundimtare** të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave dhe atë:
  - 1.1. Për dy grupet më së voni deri me datë **19.7.2025**, në ora **16:00**.
2. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **21.7.2025-23.7.2025**.

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

1. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), sipas këtij orari:
  - Fakulteti Filozofik më **25.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, më **25.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, më **25.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Arkitekturës, më **25.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, më **26.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Edukimit, më **26.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, më **26.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Filologjisë, më **27.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, më **27.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, më **27.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti Juridik, më **28.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Arteve, më **28.8.2025**, prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti Ekonomik, më **29.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Mjekësisë, më **29.8.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**.
2. Kandidatët të cilët nuk kanë arritur të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **30.9.2025**, në ora **16:00**. Jashtë këtij afati, kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen.
3. Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.
4. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit. Vendet e mbetura vakant pas humbjes së të drejtës së regjistrimit, përkatësisht lëshimit të afatit si në paragrafin 3 të Kapitullit V, nuk do të zëvendësohen me kandidatë të cilët gjinden në listën e kandidatëve të pranuar.

5. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët të tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta, atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprake. Në qoftë se edhe sukseksi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.

## VIII. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

- Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet dhe shtypet (bardh e zi) nga faqja <http://apliko.uni-pr.edu>;
- Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale;
- Sipas UA (MASHTI) Nr. 09/2021, të gjithë studentët që fillojnë studimet në Universitetin e Prishtinës lirohen nga pagesa e tarifës së shkollimit kur e regjistrojnë semestrin për herë të parë.

### I. FAKULTETI FILOZOFIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **200** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti Filozofik</b>	<b>176</b>	<b>24</b>	<b>200</b>
<b>Departamenti i Filozofisë</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
Programi Filozofi Politike	35	5	40
<b>Departamenti i Historisë</b>	<b>53</b>	<b>7</b>	<b>60</b>
Programi Histori Koha e Re	35	5	40
Programi Arkivistikë	18	2	20
<b>Departamenti i Shkencës Politike</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>30</b>
Programi Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	26	4	30
<b>Departamenti i Sociologjisë</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>30</b>
Programi Sociologji	26	4	30
<b>Departamenti i Psikologjisë</b>	<b>36</b>	<b>4</b>	<b>40</b>
Programi Psikologji shkollorë dhe Këshillim	18	2	20
Programi Psikologji Klinike dhe Komuniteti	18	2	20

Programi Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit	13	2	15
Programi Shkenca e Ushqimit	18	2	20
Programi Shkenca Bimore	13	2	15
Programi Mbrojtja e Bimëve- Fitomedicinë	9	1	10
Programi Pemëtari me Vreshtari	9	1	10

**Provimi pranues do të mbahet nga lëndët profesionale të drejtimeve përkatëse.**

## **XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **55** studentë:

Departamenti-Programi	Për studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit</b>	<b>48</b>	<b>7</b>	<b>55</b>
Programi Edukim Fizik dhe Sport, programi 1 vjeçar	22	3	25
Programi Trajner Sportiv, programi 1 vjeçar	26	4	30

**Provimi pranues:**

Provimi pranues organizohet nga fusha e Edukimit Fizik dhe Sportit dhe gjuha angleze.

Kandidatët që konkurrojnë-aplikojnë duhet të kenë të mbaruara studimet BA, me më së paku 240 ECTS në drejtimet nga lëmi sportiv.

## **XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **335** studentë dhe atë në programet si në vijim:

Departamenti-Programi	Për studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Edukimit</b>	<b>296</b>	<b>39</b>	<b>335</b>
<b>Departamenti i Edukimit të Përgjithshëm</b>	<b>124</b>	<b>16</b>	<b>140</b>
<b>Programi: Master i Shkencave të Edukimit</b>	<b>124</b>	<b>16</b>	<b>140</b>
Master i Shkencave të Edukimit: Këshillim Pedagogjik	31	4	35
Master i Shkencave të Edukimit: Edukim Inkluziv	31	4	35
Master i Shkencave të Edukimit: Mësimdhënia dhe Kurrikula	31	4	35
Master i Shkencave të Edukimit: Udhëheqja në Arsim	31	4	35
<b>Departamenti i Mësimdhënies STEM</b>	<b>106</b>	<b>14</b>	<b>120</b>